

EKSPLOKIMI I DINAMIKAVE FAMILJARE GJATË PANDEMISË COVID-19:
STUDIM KUALITATIV

MASTERI ARTEVENË PROGRAMIN PSIKOLOGJIS SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

Nga:

FATLUME KUKALAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

PRISHTINË

KORRIK, 2021

Eksplorimi i dinamikave familjare gjatë pandemisë Covid-19: Studim kualitativ

Kandidatja: Fatlume Kukalaj

Mentorja: Prof. Ass.Dr. Kaltrina Kelmendi

Qëllimi i këtij studimi është të eksploroj ndikimin e izolimit si pasojë e COVID-19, me fokus në dinamikën e çifteve gjatë periudhës së pandemisë nga perspektiva e grave, konkretisht nëse ka pasur ndryshime të caktuara në kohën e izolimit, efektet pozitive apo negative në familje përgjatë pandemisë, si dhe nëse ka pasur dhunë nga palët e përfshira si pasojë këtyre ndryshimeve. Punimi është i ndarë në 4 kapituj:

Kapitulli I: Hyrje (Përshkrimi i problemit studimor dhe kontakti kosovar)

Pandemia e virusit Covid-19 ka sjellë ndryshime në dinamikën jetësore tek grupe të caktuara në popullatën e Kosovës. Izolimi ishte një ndër masat parandaluese të përhapjes së pandemisë, që ka ndikuar ndjeshëm në dinamikën e çifteve, mirëqenien e tyre psiko-fizike dhe ndryshime tjera specifike në raportin e Në Kosovë, rastet e para u identifikuan në muajin Mars 2020, menjëherë pas identifikimit të rasteve institucionet e Kosovës vendosën masa për të parandaluar përhapjen e tij, duke çuar në ndalimin e mësimdhënies në institucionet shkollore dhe duke punuar (përveç personelit thelbësor) në sektorin publik dhe privat, mbylljen e restoranteve, ndalimi i aktiviteteve të tjera kulturore, sportive dhe politike, masat e sigurisë duke përfshirë distancën fizike dhe izolimi janë zbatuar gjerësisht në shumicën e vendeve të tjera (CDC, 2020). Derisa virusi Covid-19 është përhapur në vendet e ndryshme të botës janë miratuar masa për të ngadalsuar përhapjen e virusit me anë të distancimit social dhe izolimit. Për shkak të masave të imponuara nga strategjitë e izolimit kjo gjendje ka shkaktuar probleme ekonomike gjë që ka ndikuar që njerëzit të jetojnë në kushte stresuese, andaj një masë efektive e kontrollit të infeksionit, mund të çojë në probleme psikologjike, të cilat mund të jenë përshpejtues të stresit që mund të çojnë në dhunë.

Kapitulli II: Shqyrtim i literatures-perspektiva teorike

Teoritë që u shpjeguan në punim ishin: Modeli Social-Ekologjik; Teoria e mungesës së resurseve; Teoria e resurseve perspektiva e dhunës.

Ndryshimet e reja shkaktuan disa përparësi dhe disavantazhe. Si përparësi edhe sipas të gjeturave të studimit aktual janë se shumë punë të cilat mund të bëhen lehtësisht përmes internetit, takimet mund të bëhen me pajisje teknologjike, që do të thotë se njerëzit nuk kanë pse të humbin kohën e

tyre për të udhëtuar dhe mund të punojnë në shtëpi me rehati. Sidoqoftë, për shkak të përdorimit intensiv të internetit dhe pajisjeve të tjera teknologjike, shumë njerëz vuajnë nga palëvizshmëria, mungesa e zonës së përshtatshme të punës, efektet negative nga shikimi i kompjuterit ose telefonit për një kohë shumë të gjatë, të cilat mund të shkaktojnë probleme me gjumin.

Kapitulli III: Metodologjia

Në pjesën e metodologjisë, përshkruhen atributet e pjesëmarrësve të këtij hulumtimi, shpjegohet mënyra e mostrimit, metoda e përdorur për realizimin e hulumtimit, instrumentet matëse, çështjet etike në lidhje me pjesëmarrësit dhe analizat statistikore të përdorura për t'u dhënë përgjigje eventuale hipotezave. Në hulumtim u realizua dizajni hulumtues kualitativ, ku morrën pjesë 20 femra (gra të martuara) prej moshes 22 deri 50 vjeçare të cilat u intervistuan përmes intervistave të gjysëm-strukturara, me pyetje të bazuara në pyetësorin e hartuar. Përgjatë tërë procesit janë respektuar parimet etike në raport me pjesëmarrësit që janë përfshirë në hulumtim. Atyre u është bërë e qartë që të dhënatdo tëmbesin konfidencialedhe përdoren vetëm për qëllime të studimit

Kapitulli IV: Rezultate, Diskutim, Limitime, Rekomandime, Referenca dhe Shtojcë

Te pjesa e rezultateve, përshkruhen rezultatet në mënyrë të përmbledhur, duke ripotencuar dhe diskutuar të gjeturat në mbështetje të literaturës të parashqyrtuar, po ashtu, duke u prezantuar limitimet shkencore të studimit, të mbështetura me të dhëna konkrete për hulumtimet e radhës.

Rekomandimet e këtij studimi janë të fokusuara në aspekte praktike të funksionimit të çifteve, vecanërisht mbështetjes së grave të cilat e kanë përjetuar më së tepërmi ndryshimin e gjendjes së tyre. Pra, përveç intervenimeve apo masave të shëndetit publik që fokusohen në parandalimin e e përhapjes së pandemisë COVID-19 (siç janë: mjetet mbrojtëse, vaksinat) janë të rëndësishme të merren në konsideratë disa rekomandime tjera. Vendi ynë ka nevojë për adresim edhe të çështjeve potenciale të shëndetit mendor të ndërlidhura me pandeminë dhe pasojat e karantinës tek grupe të caktuara të popullatës, specifikisht tek gratë e martuara. Adresimi mund të bëhet përmes informimit të rregullt të grave, ku mënyrat informimit më efikase mund të jenë përdorimi i mediave elektronike dhe të shkruara, krijimi i mundësive për këshillim përmes telefonit apo në formën online, qasja në faqet online që ofrojnë materiale psikoedukative, si dhe këshilla të tjera përkatëse që mund të jenë në dobi të tyre duke iu kushtuar vëmendje e veçantë shëndetit dhe mirëqenies psikologjike e fizike. Kjo do të ndihmonte në ngritjen e vetëdijes për shëndetin mendor dhe avancimin e shërbimeve. Këto ditë ishin të vështira për të gjithë, por gjëja më e rëndësishme në kohëra si kjo është mënyra se si të menaxhohet dhe të kontrollohet situata. Për shkak të pasigurisë se kur do të përfundojë kjo pandemi, familjet duhet të vazhdojnë rutinat e tyre ditore sa më mirë që të mundën andaj duhet të përcaktohet koha e duhur për të ngrënë, fjetur, punuar, studiuar, ushtruar

apo argëtuar. Në lidhje me rutinat e përditshme, duhet të mbahet mend se ne kemi role dhe përgjegjësi të reja. Këto role të reja duhet të ndahen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë me të gjithë anëtarët e familjes, dhe secili anëtar duhet të marrë përgjegjësi të caktuara si pastrimi, gatimi, puna së bashku dhe ndihma e njëri-tjetrit. Përndryshe, nëse vetëm nëna ose babai marrin të gjitha përgjegjësitë e reja, lodhja fizike dhe psikologjike mund të shihet me kohë.

Të gjeturat theksojnë nevojën për ngritjen e mbështetjes sociale dhe profesionale për përmirësimin e shëndetit mendor për femrat (gratë e martuara) kosovare.